




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural  
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj  
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



Data: 30.08.2019

Rahovec

## THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen fermerët e komunës së Rahovecit se Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2019, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e stallave të vogla me participim për fermerët blegtor dhe shpezëtarë

### Sektorët që do të përkrahen:

- Sektori i Blegtorisë ( fermerët që posedojnë nga 3 deri në 8 krerë),
- Sektori i Shpezëtarisë ( fermerët që posedojnë nga 100 deri në 500 copë)

Të drejtën për aplikim e kanë të gjithë fermerët e komunës së Rahovecit që i përmbushin kriteret e parapara si:

- Të jetë (fermer ose fermere) i regjistruar në regjistrin e EFR-së në komunën e Rahovecit,
- Të mos jetë përfitues i granteve nga komuna e Rahovecit në tri vitet e kaluara,
- Të jetë i gatshëm të nënshkruaj marrëveshjen me kushtet e përcaktuara nga Komuna e Rahovecit.
- Të ketë gatishmëri të kryej participimin prej 20%

### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kopja e letërnjoftimit,
- Lista poseduese e tokës - certifikata e pronësisë,
- Kopja e planit të parcelës ku do të ndërtohet stalla,
- Dëshmi nga veterinarin i licencuar nga AUV
- Dëshminë mbi tatimin në pronë.

Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni i formuar pas mbylljes së afatit të aplikimit dhe do të formohet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit,



Karakteristikat e stallës:

1. Stallë për lopë qumështore me dimensione 7\*10,
2. Stallë për shpeztari me dimensione 12\*16,

Participimi i fermerëve përfitues të stallës do të bëhet duke bërë pagesën e **20%** të vlerës së përgjithshme të stallës në llogari të Komunës së Rahovecit, ndërsa pjesa tjetër e vlerës apo **80%** nga shuma e përgjithshme financohet nga Komuna e Rahovecit.

#### **Informatat dhe data e Aplikimit**

Aplikimi i fermerëve bëhet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.  
Afati i aplikimit fillon prej datës **02 Shtator 2019** deri me datën **16 Shtator 2019**

 **Drejtori për BPZHR**  
  
**Berat Duraku**